

**Vendim nr. 158 datë 10.07.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 10.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** AGIM ZELA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1511, datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 1, 2, 3, 18, 29, 31/a, 34, 42, 43, 131 pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Agim Zela është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini, e cila ka paraqitur për gjykim përpara kësaj gjykate çështjen penale në

ngarkim të tij. Ai është akuzuar për veprat penale “Vrasja me dashje e mbetur në tentativë”, dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe të municionit”, të parashikuara nga nenet 76, 22 dhe 278/5 të Kodit Penal (KP). Nga aktet e fashikullit gjyqësor ka rezultuar se në datën 11.04.2015 kërkuesi në grindje e sipër, për motive të dobëta, ka tentuar të vrasë me armë zjarri shtetasin B.V., me pasojë plagosjen e rëndë të tij.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin penal nr. 265-48, datë 11.03.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të KP-së dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim; deklarinimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe të municionit”, të parashikuar nga neni 278/5 i KP-së dhe dënimin me 1 vit burgim; në zbatim të nenit 55/2 të KP-së “Për caktimin e dënimit për disa vepra penale”, dënimin e tij me 5 vjet burgim; në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), për gjykimin e shkurtuar të dënuarit t’i ulet 1/3-ta e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim. Gjithashtu, nga gjykata është vendosur që vuajtja e dënimit të fillojë ditën e arrestit në datën 11.04.2015. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe ndryshimin e cilësimit juridik nga “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, të parashikuar nga nenet 76 dhe 22 të KP-së, në “Vrasjes së kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”, të parashikuar nga nenet 82 dhe 22; aplikimin e neneve 48, 49 dhe 59 të KP-së, si dhe shfuqizimin e nenit 278, pika 5, të KP-së nga Gjykata Kushtetuese (Gjykata) me vendimin nr. 9, datë 26.02.2016.

3. Me vendimin nr. 235, datë 24.02.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2022-1511, datë 22.11.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se vendimi është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material penal. Konkretisht, sa i përket nenit 23, pika 2, të KP-së, gjykata ka gabuar kur ka ulur dënimin nën minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë parashikuar nga neni 76 dhe 22 i KP-së. Neni 53 i këtij kodi përcakton qartë rastet e uljes së dënimit nën kufijtë e parashikuara me ligj në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka çmuar se gjykatat më të ulëta nuk kanë zbatuar drejt kriteret e nenit 53 të KP-së. Ky vendim i është komunikuar nëpërmjet *e-mail-it*, avokatit të kërkuesit në datën 23.01.2023.

5. Në datën 14.04.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, shfuqizimin e vendimit 00-2022-1511, datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari** ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 6.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka e njoftuar atë ose mbrojtësin e tij për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke mos i dhënë mundësi të parashtojë pretendime për rekursin e ushtruar nga prokuroria.
- 6.2. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme*, pasi Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen për rigjykim 6 vjet pas regjistrimit të rekursit, duke cenuar një vendim të formës së prerë, për të cilin kanë ardhur pasoja dhe është ekzekutuar, pasi kërkuari e ka vuajtur dënimin e caktuar nga të dyja shkallët e gjyqimit. Për veprën penale të parashikuar në nenet 76 dhe 22 të KP-së, nisur nga mungesa e shkaqeve të ligjshme për paraqitjen dhe shqyrtimin e rekursit, si dhe kalimi i një kohe të gjatë prej 7 vjetësh deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, kjo e fundit duhet të vendoste mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokuroria.
- 6.3. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, në drejtim të së drejtës kushtetuese për të përfituar nga ligji penal favorizues, konkretisht nenet 23 dhe 53 të KP-së.
- 6.4. *Parimit të gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, duke e orientuar këtë të fundit që të mos aplikojë nenet 23 dhe 53 të KP-së, në kapërcim të kompetencave ligjore dhe funksionale të saj. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar drejt shkaqet e ankimit të kërkuarit në gjykatën e apelit, për sa u përket rrethanave si ka ndodhur ngjarja, cilësimit juridik të veprës penale, bashkëpunimit me organin e akuzës, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat më të ulëta, duke dhënë një masë dënimi të përshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të autorit. Gjykata e Lartë nuk duhej ta pranonte rekursin e prokurorisë për veprën penale, të parashikuar në nenet 76 dhe 22 të KP-së, pasi cilësimi i kësaj vepre ka qenë i gabuar. Në rastin e tij nuk bëhej fjalë për veprën penale “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”, por për atë të “Vrasjes në kushtet e tronditjes së fortë psikike të mbetur në tentativë”, të parashikuar në nenet 82 dhe 22 të KP-së.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.<sup>14</sup> Kriteret e lartpërmendura për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

8. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimi të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin penal në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë është bartës i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të pretenduar të cenuar.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tej zgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, në ankimin kushtetues individual kërkuuesi ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-1511, datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë

gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ky vendim i Gjykatës së Lartë nuk përbën vendim përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues, për sa kohë që kërkuesi nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat për çështjen e tij. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ai i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

12. Për sa më lart, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa e paraqitur nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.